



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 3-4 nëntor është mbajtur seminari i fundit për mësimdhënësit e shkollave “M. Këpuska”, “F. Agani”, “Zekerija Rexha” dhe “Zef Lush Marku” të Gjakovës. Në fund të seancave të trajnimit, 31 mësimdhënës janë certifikuar për pjesëmarrje.

■ Më 10-11 nëntor 2007 është mbajtur seminari i katërt në kuadër të Programit “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit”. Ky seminar është mbajtur në 10 qendra të Kosovës, në Prishtinë (2 grupe), në Prizren (2 grupe), Gjakovë, Drenas, Shtime, Mitrovicë, Gjilan dhe Klinë. Raportet e trajnerëve tregojnë se gjatë këtij seminari mësimdhënësit kanë qenë shumë më aktiv se përpara në përvetësimin e teknikave dhe strategjive të MKLSH. Disa nga trajnerët shprehin mendimin se kjo është rezultat i monitorimit që është organizuar nga ana e trajnerëve dhe zbatimit të teknikave në klasa nga ana e pjesëmarrësve. Mësimdhënësit janë vetëdijësuar se zbatimi i teknikave në klasë lehtëson punën e tyre, aktivizon nxënësit dhe rrit kreativitetin në mësim. Seminari i pestë do të mbahet më 26-27 dhjetor 2007.

■ Më 24-25 nëntor 2007, është mbajtur seminari i dytë i trajnimit në kuadër të MKLSH për 19 grupe të mësimdhënësve, të cilët KEC i trajnon në bashkëpunim me MASHT. Grupet që kanë përcjellë trajnimin janë në Prishtinë, Hajvali, Podujevë, Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Pejë, Junik, Glogjan, Malishevë, Krushë e Madhe, Prizren, Suharekë, Dragash, Kaçanik, Ferizaj, Shtime, Viti dhe Gjilan.

Gjatë seminarit të dytë është prezantuar moduli “Zhvillimi kognitiv i fëmijës”.

Edukimi për të Drejtat e Fëmijës

■ Duke ditur se 20 Nëntori është dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijës, nxënësit e shkollës Mileniumi i Tretë kanë punuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës.

Këtë konventë, nxënësit e kësaj shkolle e kanë përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën gjermane dhe angleze. Mësimdhënësja Vjosa Vula, ishte ajo e cila është përkujdesur që kjo broshurë të realizohet dhe të përkthehet, dhe po ashtu të shërbejë për avancimin e cilësisë së mësimdhënies në gjuhën gjermane, si dhe të ketë ndikim edukativ për nxënësit e kësaj shkolle.

Konventa e përkthyer në të dy gjuhët është publikuar në ueb faqen www.childrights-ks.org

Edukimi Multikulturor dhe Multietnik

■ Programi zhvillohet sipas dinamikës së projektit. Muaji nëntor ishte muaji kur edhe mbaruan të gjitha trajnimet dhe certifikimi i të gjithë mësimdhënësve që kanë ndjekur këto trajnime. Gjithsej janë certifikuar 257 mësimdhënës.

Aktivitetet sociale, po ashtu janë duke u bërë sipas dinamikës së projektit. Këtë muaj janë mbajtur 2 aktivitetet e fundit sociale për këtë projekt.

Aktiviteti social në Gjakovë: është organizuar me një numër prej 35 nxënësve. Nxënësit fillimisht janë takuar në shkollën “Yll Morina” ku kanë zhvilluar

disa lojëra njoftimi me njëri tjetrin. Pas kësaj, ata janë dërguar në Muzeun e qytetit të Gjakovës ku të gjithë fëmijët patën rastin të shohin bukuritë e këtij Muzeu.

Aktiviteti social në Mitrovicë: Në këtë aktivitet morën pjesë tridhjetë nxënës nga njëmbëdhjetë shkolla të ndryshme të Mitrovicës me fshatrat përreth. Ky ishte një grup i fëmijëve multi-etnik i përbërë prej shqiptarëve, boshnjakëve, ashkalive dhe romëve.

Takimi i fëmijëve u bë në SH.F. "Çajupi" ku së bashku me ta zhvilluam një aktivitet social që kishte të bëjë me prezantimin e pjesëmarrësve në këtë aktivitet.

Së bashku vazhduam rrugën që të vizitojmë Muzeun e Qytetit, ku grupi i fëmijëve u njoh për së afërmi me kulturën e lashtë të këtyre trojeve si dhe shumë eksponate të antikës.



■ Pas dreke fëmijët vazhduan rrugën me kombi-bus drejt Flotacionit të Trepçës në Tunelin e Parë, ku patën mundësi të njihen me një pjesë të gjigantit të madh të Trepçës.

Mirëpo ajo çka u bëri më së shumti përshtypje ishte vizita e Muzeut të Kristaleve në Stantërg ku u njohën me pasuritë e nëntokës, llojlojshmërinë e kristaleve si dhe puna që bëhet në zgafelle për nxjerrjen e mineraleve nga thellësitë e nëntokës.



Këtë muaj, në kuadër të këtij projekti jemi duke punuar edhe në organizimin e disa tryezave të rrumbullakëta.

Hap pas Hapi

■ Me 15 nëntor në lokalet e KEC u mbajt takimi me kontakt personat e Institucioneve parashkollore të cilat punojnë me metodologjinë Hap pas Hapi. Me këtë rast u mbajt punëtorja për planifikim, e cila përfshin projektin një javor për integrimin e njësive mësimore në qendra të aktiviteteve. Në takim u vendos që pjesa e dytë e punëtorisë të mbahet në fillim të janarit 2008.

■ Gjatë muajit nëntor u mbajtën disa trajnime të cilat financohen nga MASHT. Në Prishtinë në datat 17-18 dhe 24-26 nëntor, u mbajt trajnimi bazik për klasën e parë. Në Gjilan më 23-25 nëntor u mbajt trajnimi bazik për klasën e parë. Gjithashtu, edhe në Gjakovë 23-25 nëntor u mbajt trajnimi për klasën e dytë.

■ Po ashtu, u mbajtën edhe disa trajnime të cilat financohen nga KEC. Në Prishtinë u organizua edhe një trajnim bazik për klasën e parë me datat 23-25 nëntor dhe me 01 e 02 dhjetor. Në Gjakovë, me datat 30 nëntor, 01 dhe 02 dhjetor, vazhdoi edhe një grup për klasën e dytë, grup i cili ishte formuar gjatë vitit të kaluar.

Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

■ Me datat 6-8 nëntor në Prizren u mbajt trajnimi “Hartimi i Politikave”. Trajner në këtë trajnim ishte Katalin Pallai nga Hungaria, ndërsa pjesëmarrësit ishin anëtarë të SBASHK, KAHCR, KEC, si dhe nga një përfaqësues nga MASHT, MPMS, AKK. Pjesëmarrësit u ndanë shumë të kënaqur nga ky trajnim.



■ Me datën 18.11.2007, anëtarët e Grupit Punues për Zhvillimin e Politikave u nisën për Slloveni në një vizitë studimore që zgjati 4 ditë. Grupi prej 7 anëtarësh përbëhej nga përfaqësues të KEC, SBASHK, KAHCR, MPMS dhe AKK. Në Slloveni u vizituan Sindikata e Arsimit, Lidhja e Sindikatave të Bashkuara, Ministria e Arsimit, Ombudspersoni dhe dy shkolla ku edhe u njoftuan me përvojën e Sllovenisë në zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me vijimin arsimit nga nxënësit.



Ndërsa me datën 19.11.2007 një grup prej 7 anëtarë të tjerë të Grupit Punues u nisën për në Kroaci, po ashtu për një vizitë studimore. Grupi përbëhej nga përfaqësues të KEC, SBASHK, KAHCR dhe MASHT. Në Kroaci u vizituan Ministria e Arsimit, Ombudspersoni për fëmijë, Komitetin Kroat të Helsinkit, Agjencia për Arsim dhe Trajnim.



Në të dy vizitat u morën përvoja të rëndësishme për Zhvillimin e Politikave.

■ Gjatë dhjetorit do të fillojë aktiviteti për trajnimin e 500 mësimdhënësve në tri fusha:

- Edukim për të Drejtën Shoqërore
- Të Drejtat e Fëmijëve
- Avokim

Fillimisht do të fillohet me 7 grupe trajnimi. Deri më tani përgatitjet për këto trajnime janë duke shkuar mirë.

Edukimi për të drejtën shoqërore

■ Gjatë muajit nëntor, në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar 6 takime nëpër qendra të Kosovës. Takimet u zhvilluan nëpër ato qendra ku edhe janë mbajtur trajnimet.

Takimet kanë qenë të dedikuara për pjesëmarrësit e trajnimeve që janë zhvilluar me herët në kuadër të këtij projekti. Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë

që të diskutohet rreth trajnimit në përgjithësi, si dhe në veçanti për temat që janë trajtuar gjatë tri ditëve të trajnimit. Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë treguar se sa ka ndihmuar ky program trajnimi në zvogëlimin e paragjyqimeve dhe stereotipeve tek ata, si dhe tek të tjerët, veçanërisht tek fëmijët me të cilët punojnë.

Takimet kanë pasur karakter më të gjere, duke filluar me ligjërime, debate si dhe aktivitete të ndryshme sociale. Në fund të çdo takimi është bërë certifikimi i pjesëmarrësve për 3 ditët e trajnimit, respektivisht për Modulin I, të këtij programi.



Pjesëmarrësve kanë qenë shumë të kënaqur me trajnimin dhe kanë kërkuar që të vazhdohet edhe me Modulin II.

■ Programi “Edukimi për të Drejtën Shoqërore” i financuar nga Banka Botërore është duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit.

Trajnimet e mësimdhënësve kanë mbaruar. Janë certifikuar gjithsej 194 pjesëmarrës. Struktura e këtyre pjesëmarrësve ka qenë e përzier. Ka pasur mësimdhënës, prindër na komunitetet RAE, përfaqësues të OJQ-ve të ndryshme. Në këtë muaj është zhvilluar edhe aktiviteti i fundit social i cili u mbajt në Gjakovë. Nxënësit e shkollave të ndryshme të kësaj Komune patën rastin që të njihen me njëri tjetrin dhe të punojnë së bashku në një punëtori të vogël e cila u organizua enkas për ta.

Access Microscholarship Program

■ Mësimi po zhvillohet ashtu siç është e paraparë në projekt. Nxënësit pjesëmarrës në këtë projekt, nga Komuna e Prishtinës kanë pasur rastin të zhvillojnë aktivitetin e parë social për këtë semestër. Aktiviteti u zhvillua me 40 nxënës të cilët kanë kaluar disa orë duke luajtur në fushë sporti lojën e dashur të tyre-Frizby.



■ Edhe këtë muaj planifikohet një aktivitet social ku do të përfshihen edhe nxënësit e Komunës së Prizrenit. Do të mbahet një Party për festat e fundvitit. Kjo do të organizohet në muajin dhjetor pasi që edhe me këtë aktivitet mbaron edhe semestri i parë i këtij viti për këta nxënës.

Projekti i përbashkët i Historisë

■ Përfaqësuesi i KEC ka marrë pjesë në seminarin 1-ditor me titull “Projekti i përbashkët i Historisë” që është mbajtur në Tiranë më 1 dhjetor 2007. Ky seminar kishte të bënte me përgatitjen e trajnerëve, të cilët do të përhapnin idenë e inkorporimit të materialeve të ndryshme të historisë në kurrikulin e tyre shkollor. Projekti është iniciativë e Qendrës për Demokratizim dhe Pajtuëshmëri në Vendet e Evropës Juglindore me qendër në Selanik të Greqisë. Pritet që ky projekt të fillojë implementimin dhe në Kosovë.

Përgatiti: Petrit Tahiri